

Nr.350, datë 23.5.1998

**PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E DISA PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE DHE
KONSULLORE**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e Ambasadës të Republikës së Shqipërisë në Izrael. Selia e ambasadës të jetë në Tel- Aviv.
2. Hapja e Zyrës së Përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në Bosnjë Hercegovinë. Selia e zyrës të jetë në Sarajevë.
3. Hapja e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Republikën Italiane me seli në Bari.
4. Hapja e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Republikën Greke me seli në Selanik.
5. Mbyllja e Ambasadës të Republikës së Shqipërisë në Pakistan (Islamabad). Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**